



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA



REZOLUTË

**MBI PABAZUESHMËRINË E PRETENDIMEVE PËR TRAFIKIMIN
E PALIGJSHËM TË ORGANEVE NJERËZORE NË KOSOVË DHE SHQIPËRI**

1. Duke iu referuar rezolutës 1782 (2011) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (APKiE) “Për hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë”, e cila bazohej në një raport (Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011) të Dik Martit (*Dick Marty*), asokohe anëtar dhe raportues i Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut në APKiE;

2. Duke rikujtuar se raporti u hartua në vijim të një mocioni për rezolutë (Dokumenti 11574, datë 15 prill 2008), me autor ish-anëtarin e APKiE-së, Kostandin Kosaçev (*Konstantin Kosachev*), Federata Ruse, Grupi European Demokrat, bazuar në kujtimet e zonjës Karla Del Ponte (*Carla Del Ponte*), ish-Prokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë (ICTY), e cila në librin e saj “Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës”, botuar dy muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe rreth tre muaj pasi kishte dhënë dorëheqjen si prokurore e ICTY-së, ngrinte dyshime se pjesëtarë, drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kishin kryer trajtime çnjerëzore të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe në Shqipëri, krime këto që nuk mund të hetoheshin nga ICTY-ja për mungesë juridiksioni, si dhe për shkak të mandatit të kufizuar në kohë dhe territor të kësaj gjykate; këto pretendime ishin hetuar edhe më parë nga zyra e ICTY-së gjatë mandatit të Del Pontes, por nuk ishin gjetur prova për të bazuar pretendimet për kryerjen e këtyre krimeve;

3. Duke nënvizuar se raporti i Dik Martit, në vijim të pretendimeve të ish-prokurores Karla Del Ponte dhe mocionit për rezolutë të nisur prej deputetit rus në APKiE, Kosaçev, edhe pse nuk është një raport faktmbledhës apo hetimi, ngre pretendime për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore, që dyshohen të jenë kryer nga pjesëtarë dhe drejtues të UÇK-së ndaj shtetasve serbë, kosovarë dhe komunitetit rom apo minoriteteve të tjera të Kosovës në territorin shqiptar, më konkretisht në Veri të Shqipërisë: Kukës, Burrel, Rripe, Cahan dhe Fushë-Krujë, në periudhën pas përfundimit të luftës në Kosovë, kryesisht pas qershorit të vitit 1999, dhe ka shërbyer si dokumenti ku bazohen rekomandimet në rezolutën 1782 (2011) të APKiE-së drejtuar vendeve anëtare të Këshillit të

Europës, Bashkimit European, organizatave ndërkombëtare, Kosovës, Shqipërisë, Serbisë dhe mbi të cilin u realizuan një sërë nismash kushtetuese dhe/ose ligjore dhe rregullatore, si dhe veprimtari institucionale në Kosovë, Shqipëri dhe Bashkimin European (EULEX), siç përshkruhen në vijim në këtë rezolutë;

4. Duke vlerësuar Kuvendin e Kosovës që pati vullnetin politik, edhe pse disa prej atyre të cilët votuan ishin të akuzuarit e krimeve të pretenduara në raportin e Dik Martit për të miratuar amendamentin kushtetues n.24 të gushtit 2015, që parashikoi krijimin e dhomave të specializuara për ndjekjen penale mbi pretendimet që lidhen me çfarë pretendohet në raportin e Dik Martit dhe që ishte objekt hetimi edhe nga Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit European, ngritur sipas vendimit të muajit maj të vitit 2011 të Komitetit Politik dhe Sigurisë së Bashkimit European për disa ndryshime në planin operacional të EULEX-it, në vijim të rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së;

5. Duke sjellë në vëmendje se veprimin e klasës politike të Kosovës për amendamentin kushtetues n.24 të gushtit 2015 e vlerësoi edhe APKiE-ja në rezolutën 2094 (2016) “Situata në Kosovë dhe roli i Këshillit të Europës”, e cila në pikën 3 thotë shprehimisht: “Asambleja mirëpret miratimin nga Kuvendi i Kosovës të amendamenteve kushtetuese, të cilat i hapën rrugën krijimit të dhomave të specializuara për ndjekjen penale të rasteve të hetuara nga Task Forca Hetimore Speciale, si vazhdim i rezolutës së Asamblesë 1782 (2011) për hetimin e pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë. Asambleja e konsideron këtë vendim si një hap drejt pajtimit dhe një shenjë e gatishmërisë së pushtetit për të luftuar mosndëshkimin.”;

6. Duke vlerësuar dhe rikujtuar gjithashtu se në zbatim të amendamentit kushtetues, si dhe ligjit nr. 04/L -274 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European mbi misionin e Bashkimit European për sundim të ligjit në Kosovë”, Kuvendi i Kosovës miratoi edhe ligjin nr. 05/L -053 “Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”, duke u dhënë juridiksionin këtyre organeve të pavarura dhe të përkohshme, pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, në përbërje të së cilave nuk ka shtetas kosovarë, për të hetuar e ushtruar ndjekjen penale për krimet e supozuara që janë raportuar në raportin e Dik Martit dhe që kanë qenë edhe objekt i hetimeve penale të kryera nga Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit European;

7. Duke nënvizuar se as Task Forca Hetimore Speciale e Bashkimit European, e kryesuar nga Klint Uilliamson (*Clint Williamson*), e autorizuar në vitin 2011 për një hetim të plotë penal për akuzat për vrasje të personave, me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre, nuk gjeti kurrë prova dhe fakte në mbështetje të pretendimeve në raportin e Dik Martit;

8. Duke vënë në dukje se as Zyra e Prokurorit të Specializuar, që është krijuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht individë për krime të supozuara në raportin e Dik Martit, në asnjë prej hetimeve të saj e në asnjë prej aktakuzave që u ngritën kundër ish-drejtuesve të UÇK-së në vitin 2020, nuk përmend asnjë rast që të lidhet me trafikimin e organeve njerëzore;

9. Duke theksuar gatishmërinë dhe vullnetin e Shqipërisë për të bashkëpunuar pa rezerva me të gjitha institucionet ndërkombëtare, me qëllim që t’u jepet një përgjigje përfundimtare pretendimeve në raportin e Dik Martit dhe për t’i shkuar deri në fund këtij procesi, për të mbyllur njëherë e mirë kapitullin se në Shqipëri nuk janë kryer krime të supozuara si ato që përmenden në raportin e Dik Martit, si dhe duke nënvizuar asistencën dhe bashkëpunimin efektiv të Shqipërisë me çdo mision faktmbledhës ose investigues të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës, EULEX-it, Bashkimit European apo tjetër që kanë pasur interes të kryejnë investigime veçanërisht në zbatim të rekomandimeve të rezolutës së APKiE 1782 (2011) edhe përpara se të ngriheshin Dhomat e Specializuara apo Zyra e Prokurorit Special në Kosovë;

10. Duke vënë në dukje se shprehje e vullnetit të Shqipërisë për të bashkëpunuar në interes të drejtësisë dhe zbardhjes së të vërtetës për krimet e supozuara në raportin e Dik Martit është edhe miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 53/2012 “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it”, i cili autorizon autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë t’i ofrojnë Task Forcës Hetimore Speciale të Bashkimit Europian bashkëpunimin dhe ndihmën përkatëse që u kërkohet;

11. Duke rikujtuar se miratimi i ligjit nr. 53/2012 nga Kuvendi i Shqipërisë është vlerësuar në raportin e APKiE-së (Dokumenti 13586, datë 2 shtator 2014), “Respektimi i detyrimeve dhe angazhimeve nga Shqipëria”, ku në pikën 5.5 “Ndjekja e raportit të Asamblesë për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë”, paragrafi 129, shprehimisht thuhet: “Ne mirëpresim faktin që autoritetet shqiptare kanë ofruar një bashkëpunim të plotë dhe të papenguar për hetuesit e EULEX-it për këto krime të supozuara në territorin shqiptar. Duke e konsideruar me rëndësi të madhe që pretendimet e ngritura në këtë raport të hetohen plotësisht dhe në mënyrë transparente, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin “Për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale me Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it” në maj të vitit 2012. Bazuar në këtë ligj, prokurorët e EULEX-it lejohen të hetojnë brenda territorit shqiptar për implikimet e supozuara të Shqipërisë në trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në territorin shqiptar. Ata kanë pasur mbështetjen e plotë të të gjitha institucioneve kompetente. Në lidhje me hetimin e pavarur dhe të veçantë nga autoritetet shqiptare, siç kërkohet nga Kuvendi, autoritetet deklaruan se hetimet e tyre deri më tani nuk kanë konfirmuar gjetjet e Martit.”;

12. Duke nënvizuar se pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 53/2012, autoritetet shqiptare bashkëpunuan ngushtësisht me Task Forcën Hetimore Speciale të Bashkimit Europian dhe organet e specializuara në Kosovë, duke ofruar të gjithë ndihmën, asistencën e nevojshme, informacionet e kërkuara, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse në lidhje me to, me qëllim zbardhjen e të vërtetës mbi pretendimet në raportin e Dik Martit;

13. Duke konstatuar se nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 53/2012 e deri më sot asnjë prej organeve të specializuara në Kosovë apo organizatat ndërkombëtare nuk kanë ngritur asnjë pretendim për mungesën e bashkëpunimit të autoriteteve shqiptare në këtë proces;

14. Duke nënvizuar seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e Kuvendit të Shqipërisë për të ushtruar kontrollin parlamentar për zbatimin e rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së, si dhe të ligjit nr. 53/2012, me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 71/2020 u ngrit një komision i posaçëm për realizimin e këtij funksioni parlamentar, i cili nuk e përmbylli dot veprimtarinë e tij për shkak të mbarimit të legjislaturës së IX të Kuvendit (2017-2021), por arriti të marrë informacione e raporte të plota që vërtetojnë se gatishmëria e autoriteteve shqiptare ka qenë efektive dhe këto autoritete u janë përgjigjur në kohë e me konstruktivitet kërkesave të autoriteteve të huaja për bashkëpunim, ndihmë, asistencë dhe veprime konkrete sipas përcaktimeve të ligjit nr. 53/2012, duke përmbushur kështu njëkohësisht edhe rekomandimet e rezolutës 1782 (2011) për Shqipërinë;

15. Duke konstatuar se nga aktet, provat, raportet dhe informacionet që mblodhi komisioni i posaçëm ngritur me vendim të Kuvendit nr. 71/2020, nuk ka asnjë fakt apo provë që të vërtetojë pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje të personave me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe/apo në Shqipëri;

16. Duke theksuar se Dik Martit, pas vizitave që kreu si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kurrë deri më sot nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar krimet e supozuara të kryera në lidhje me trafikimin e organeve njerëzore, siç pretendon në raportin e tij;

17. Duke qenë se kësisoj, edhe pas më se një dekade nga rezoluta 1782 (2011) e APKiE-së rezulton se asnjë nga misionet dhe/apo hetimet e organeve të drejtësisë vendase apo ndërkombëtare nuk kanë gjetur asnjë fakt e asnjë provë që të vërtetojë pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje me qëllim trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë dhe/apo në Shqipëri;

18. Duke respektuar dhe pa ndërhyrë në asnjë hetim apo procedurë gjykimi ndaj personave të veçantë, udhëheqësve të luftës së UÇK-së dhe duke qenë të përkushtuar për zbatimin e plotë të rekomandimeve të rezolutave të APKiE-së si vend anëtar i Këshillit të Europës;

19. Duke ndarë të njëjtin mendim me Dik Martit, aty ku shprehet në raportin e tij se: “E vërteta dhe përgjegjshmëria janë nevoja absolute nëse duhet të ketë pajtim dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon”;

20. Duke vlerësuar legjitimitetin e luftës heroike të UÇK-së për çlirimin e vendit dhe duke qenë të bindur se, pavarësisht se nuk mund të vendosen paralele midis masakrave çnjerëzore, spastrimeve etnike, deportimeve, vrasjeve, përdhunimeve, plaçkitjeve dhe krimeve të luftës nga drejtues dhe anëtarë të makinerisë zyrtare luftarake serbe dhe paramilitarët e saj gjatë luftës në Kosovë nga njëra anë, dhe integritetit e kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së si reagim në mbrojtje të jetës dhe lirisë së popullit në Kosovë nga ana tjetër, çdo dyshim për krime duhet zbardhur nga organet e drejtësisë sipas parimeve të procesit të rregullt ligjor, por procesi për këtë çështje do të duhet të mbarojë dikur, me qëllim që popujt të gjejnë forcën të pajtohen e të jetojnë së bashku duke shëruar plagët e së shkuarës,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

Konstaton se pas më shumë se dhjetë vjetësh hetime të thelluara nga Task Forca Hetimore Speciale e BE-së dhe pasardhësja e saj, Zyra e Prokurorit të Specializuar, pretendimet e ngritura në raportin e Dik Martit për vrasje të personave me qëllim nxjerrjen dhe shitjen e organeve të tyre dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, të përfshira në rezolutën 1782 (2011) të APKiE-së, pikat 1 dhe 4, mbeten të paargumentuara, të paprovuara dhe të pabazuara në prova dhe fakte e për rrjedhojë duhet të konsiderohen si të tilla nga të gjitha institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

Përgëzon autoritetet e Republikës së Kosovës, të cilat në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 19.6 të rezolutës 1782 (2011) të APKiE-së kanë bashkëpunuar pa rezerva me EULEX-in dhe çdo organ tjetër gjyqësor të mandatuar për të kryer hetime vijuese, si dhe në kuadër të çdo procedure tjetër që synon të zbulojë të vërtetën.

Përsëritet autoritetet e Kosovës, të cilat në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare dhe amendamentin kushtetues nr. 24 të gushtit 2015 miratuan themelimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe të natyrës së përkohshme, me qëllim kryesor hetimin dhe/ose gjykimin e krimeve të pretenduara në raportin e Dik Martit.

I bën thirrje Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të realizojë një raport vijues (*follow up report*) dhe si rrjedhojë edhe një rishikim të rezolutës 1782 (2011) duke rivlerësuar pretendimet për trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Shqipëri dhe/apo në Kosovë, në dritën e zhvillimeve që kanë ndodhur gjatë kësaj dekade, fakteve, provave dhe informacioneve të përditësuara, sikurse edhe për sa i përket angazhimit, gatishmërisë dhe bashkëpunimit të plotë të Shqipërisë dhe Kosovës në shërbim të së vërtetës dhe vendosjes së drejtësisë.

I kërkon qeverisë shqiptare të mbetet plotësisht e përkushtuar për të ndihmuar drejtësinë dhe identifikuar përgjegjësinë për të gjitha krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe përsërit thirrjen e tij për të gjithë të interesuarit që të bashkëpunojnë me Mekanizmin Ndërkombëtar për kryerjen e funksioneve të mbetura të gjykatave penale (IRMCT) brenda juridiksionit të saj.

Shpreh vullnetin e palëkundur për të ndihmuar drejtësinë dhe mbështetur çdo përpjekje që synon të zbulojë të vërtetën.

Miratuar në datën 21.7.2022